

AKTI I THEMELIMIT
&
STATUTI I SHOQËRISË
KING SHPK
(Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

Në bazë të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, i ndryshuar, u vendos si më poshtë vijon:

KREU 1
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e themelimit dhe emri i shoqërisë

Sot më datë 06.07.2023 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **KING SHPK** (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

Themeluesit e Shoqërisë janë :

- 1: OLTJAN HOXHOLLI**, shtetas shqiptar, lindur më 29.09.1981 në Tiranë, banues në Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Gjini Bue Shpata, Nd. 1834, H. 1, Ap. 008, 1019, Tiranë, mbajtës i Kartes se Identitetit me Nr. Personal I10929118F, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2: SHOQERIA GK INVEST SHPK**, me seli të regjistruar në adresën Njesia administrative Nr. 2, Rr. Themistokli Germenji, Pallati Pegaso, Kati 1, Ap. 2, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar me numer unik identifikimi të subjektit tregtar (NIPT) M21904049C;
- 3: ALKET MESLANI**, shtetas shqiptar, lindur më 06.09.1974, në Poliçan, Skrapar, banues në Njësia Administrative Nr. 5, Rruga Bajram Curri, Nd. 048, 1019, Tiranë, , mbajtës i Kartes se Identitetit me Nr. Personal H40906080N, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 4: GERTI ÇALLIKU**, shtetas shqiptar, lindur më 03.09.1976, në Tiranë, banues në Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga. Stavri Themeli 5/9, Tiranë, mbajtës i Kartes se Identitetit me Nr. Personal H60903146W , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Neni 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Investime në ndërtim dhe investime në pasuri të paluajtshme. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë edhe aktivitetet tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve , konsulencës tregtimin e mallrave të ndryshëm . Për të arritur objektin e saj , Shoqëria mund të realizojë drejtperdrejte apo në mënyrë të tertorte cdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare e të huaja , si edhe të hyjë në marrëdhënie kontraktore , bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë , private ose

publike , vendas ose te huaj . Shoqëria mund te ushtroje cfaredolloj aktiviteti tjetër te papercaktuar ne kete akt , te cfaredolloj natyre qe nuk eshte ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi pa asnje kufizim.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën- Njesia administrative Nr. 2, Rr. Themistokli Germenji, Pallati Pegaso, Kati 1, Ap. 2 – Tirane, Shqiperi.
2. Shoqëria ka të drejtë të hap degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të vendit, gjatë aktivitetit te saj.

Neni 5

Të Ndryshme

1. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të zmadhojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblese së Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas parashikimeve të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali i regjistruar

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100,000 (njqind mije) Lekë , i perbere nga 4 kuota . Kapitali i regjistruar është plotësisht i paguar, dhe përbëhet nga kuotat, e zotëruara nga Ortaket në përputhje me nenin 7 dhe shtojcës 1 të këtij Statuti.

Neni 7

Ortakët e Shoqërisë

1. Ortakët e Shoqërisë janë Personat/Shoqeri që kanë përfituar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet midis Ortakëve në kuota në përputhje me kontributet përkatëse në kapital. Kontributi mund të jetë në para ose natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme apo të drejta të ortakëve)
2. Ortakët aktuale të Shoqërisë janë të listuar në Shtojcën 1 që i bashkëlidhet këtij Statuti.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë kryhet me vendim të Asamblese së Ortakëve.

2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të përfshirjes së fitimeve apo rezervave në kapital ose me ane të kontributeve të reja.
3. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributëve të reja në para, këto kontribute duhet të nënshkruhen jo më vonë se 30 ditë pasi është vendosur rritja e kapitalit. Këto kontribute duhet të shlyhen plotësisht jo më vonë 30 ditë pas datës së nënshkrimit. Asambleja e Ortakëve mund të përcaktojë afate të ndryshme në vendimin e zmadhimit të kapitalit.
4. Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar me anë të kontributeve të reja në natyrë, këto kontribute duhet t'i transferohen Shoqërisë përpara regjistrimit në Regjistrin Tregtar. Vlerësimi i kontributeve të reja në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.
5. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
6. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
7. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Fitimi dhe kalimi i kuotave

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet :
 - a. kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b. shitblerjes së kuotave;
 - c. trashëgimisë;
 - ç. dhurimit;
 - d. çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë janë të transferueshme lirisht ndërmjet ortakëve.
3. Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.
4. Në rast të transferimit të kuotave tek persona të tjerë jashtë Shoqërisë, qofte me shitje apo qofte me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortaket e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojë këto të drejta brenda 60 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat. Mosrespektimi i kesaj dispozite e ben të pavlefshëm transferimin e kuotave.
5. Perjashtimisht nga sa me sipër, e drejta e parablerjes nuk zbatohet në rastet kur bleseri i mundshëm i trette është bashkeshorti/bashkeshortja/ apo femijet. Në këto rast kuotat e kapitalit janë të transferueshme lirisht midis paleve.
6. Vlera e kuotes që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marreveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakort.

KREU III
ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi vendimarrës

1. Organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të përshkuara si më poshtë:
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorit;
 - ç. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi (me prokurë me shkrim), nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur Asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur në paragrafin e mësipërm të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve të personave të përcaktuar në pikat b dhe c të këtij paragrafi;
 - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - g. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 14

Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;

- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortak u përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortak, të cilin përfaqëson.

Neni 15

Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një administrator i cili caktohet në statutin e Shoqërisë dhe më pas nga Vendimet Asamblesë së Ortakëve. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh me të drejtë rrimërimi nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
2. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
 - a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblës së përgjithshme për miratim;
 - d. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh. kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e. raportojë përpara asamblës së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - f. të therrase Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:
 - i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
 - ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
 - iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Administrator i Shoqërisë është **OLTJAN HOXHOLLI**, shtetas shqiptar, lindur më 29.09.1981 në Tiranë, banues ne Njesia bashkiake nr. 5, Rruga Gjin Bue Shpata, Nd. 1834, H. 1, Ap. 008, 1019, Tiranë, mbajtës i Kartes se Identitetit me Nr. Personal I10929118F , madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Specimeni i nënshkrimit të Administratorit është sipas përcaktimit në shtojcën 2 bashkëlidhur statutit.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare“, i ndryshuar, Administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, të parashikuara, është i detyruar t’i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
6. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 17

Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 18

Konfidencialiteti dhe

Ruajtja e sekretit

1. Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Shoqërisë.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

Neni 19

Viti financiar

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet në 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertët

1. Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një eksperti. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko



tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

2. Në rast se kërkohej nga ligji, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel të Shoqërisë do të kryhet nga eksperti kontabel i emëruar për një periudhë 1 vjeçare me mundësi për tu rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Në përfundim të kontrollit eksperti i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
 - dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.
2. Në rast se Shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për ç'rregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Në rast se ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 22

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi- ndarja

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 23

Baza ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e të saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisilacionit shqiptar në fuqi.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

1. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 25

Dispozitat Përfundimtare

1. Ky statut do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga themeli i shoqërisë.
2. Të gjitha ndryshimet e këtij statuti do të aprovohen përmes së njejtës procedure.
3. Në të gjitha çështjet që nuk përcaktohen në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare

THEMELUESIT

Oltjan Hoxholli



Shoqeria Gk Invest SHPK

Perfaqësuar nga: Gramoz Kryemadhi


GRAMOZ KRYEMADHI



Alket Meslani



Gerti Çalliku



SHTOJCA 1
(ORTAKËT E SHOQËRISË)

1: OLTJAN HOXHOLLI, shtetas shqiptar, lindur më 29.09.1981 në Tiranë, banues në Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Gjirin Bue Shpata, Nd. 1834, H. 1, Ap. 008, 1019, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal I10929118F, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar është zotëruar i 1 kuote ose, me vlerë të përgjithshme 25'000 (njetete e pese mijë) Lekë, që përbejnë 25% të kapitalit themeltar.

2: SHOQERIA GK INVEST SHPK, me seli të regjistruar në adresën Njësia administrative Nr. 2, Rr. Themistokli Germenji, Pallati Pegaso, Kati 1, Ap. 2, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar me numer unik identifikimi të subjektit tregtar (NIPT) M21904049C është zotëruar e 1 kuote ose, me vlerë të përgjithshme 25'000 (njetete e pese mijë) Lekë, që përbejnë 25% të kapitalit themeltar.

3: ALKET MESLANI, shtetas shqiptar, lindur më 06.09.1974, në Poliçan, Skrapar, banues në Njësia Administrative Nr. 5, Rruga Bajram Curri, Nd. 048, 1019, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal H40906080N, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar është zotëruar i 1 kuote ose, me vlerë të përgjithshme 25'000 (njetete e pese mijë) Lekë, që përbejnë 25% të kapitalit themeltar.

4: GERTI ÇALLIKU, shtetas shqiptar, lindur më 03.09.1976, në Tiranë, banues në Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga Stavri Themeli 5/9, Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal H60903146W, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar është zotëruar i 1 kuote ose, me vlerë të përgjithshme 25'000 (njetete e pese mijë) Lekë, që përbejnë 25% të kapitalit themeltar.



Oltjan Hoxholli




Shoqeria Gk Invest SHPK

Perfaqësuar nga: Gramoz Kryemadhi

GRAMOZ KRYEMADHI



Alket Meslani



Gerti Çalliku

